

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ – DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA. në trupin gjykues të përbërë prej gjyqtarit Ibrahim Idrizi, kryetar i trupit gjykues, dhe gjyqtarëve profesional Kadrije Goga-Lubishtani dhe Sahit Krasniqi anëtarë të trupit gjykues, me sekretaren juridike Arbelinda Tahiri, në çështjen penale ndaj të akuzuarve I.R. ,H.K,S.Rr. dhe Rr.M., për shkak të veprës penale trafikim me njerëz nga neni 139 par. 1 të KPK-së, i akuzuar nga ish PPQ në Prishtinë me aktakuzën PP.nr.390-1/2012 të datës 31.07.2012, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor, në prani të prokurorit të shtetit Florije Salihu Shamolli, të akuzuarit dhe mbrojtësve të tij avokatëve E.Sh. e B.S., më datë 9 shkurt 2016, shpalli dhe komunikoi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari, B.S., i biri i I. dhe nënës Gj. e vajzërisë M. Data e lindjes....., numër personal, me vendbanim në fshatin, K. Ferizaj, shqiptar, shtetas i R. Kosovës, ka të kryer shkollën e mesme, i pa punësuar, i ve, prind i 3 fëmijëve, me gjendje të dobët ekonomike, ka qëndruar në paraburgim prej datës 12.05.2005 deri më 13.06.2005.

Në bazë të nenit 390 par.1 nën par.3 të KPPK-së,

LIROHET NGA AKUZA

Sepse, që nga viti 2008 e në vazhdimësi deri në fund të muajit maj 2012, i ka trafikuar seksualisht të dëmtuarat L.P. dhe N.H. në atë mënyrë që me anë të mashtrimit duke shfrytëzuar gjendjen e dobët ekonomike, me tentime të ndryshme për punësime si dhe premtime tjera ku i ka detyruar që të kenë marrëdhënie seksuale me të akuzuarin si dhe me personin R.B., e gjithë kjo me qëllim të përfitimit pasuror, pasi që R.B. ishte e Shtërpcës e gjithë kjo me qëllim të përfitimit pasuror për të fituar ndonjë tender, ku të dëmtuarat i ka shfrytëzuar seksualisht duke u premtuar se do ta hap një qendër tregtare dhe do t'i punësoj, ndërkaq pas çdo marrëdhënie seksuale i njëjti u ka paguar para në shuma të ndryshme prej 50-100 euro,

-me çka do të kryente veprën penale trafikim me njerëz nga neni 139 par. 1 në të KPK-së.

Meqë nuk është provuar se i akuzuari ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet me akuzën e prokurorit të shtetit.

Shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore.

A r s y e t i m i

1. Historiku i procedurës

Ish Prokuroria Publike e Qarkut në Prishtinë, me aktakuzën PP.nr.390-1/2012 të datës 31.07.2012, e ka akuzuar B.S., për shkak të veprës penale trafikim me njerëz nga neni 139 par. 1 të KPK-së.

Me aktgjykimin P.nr. 594/2012 datë 27.11.2012 të ish Gjykatës të Qarkut në Prishtinë i akuzuari është shpallur fajtor për veprën penale trafikim me njerëz nga neni 139 par. 1 të KPK-së.

Gjykata e Apelit e Kosovës me aktvendimin PAKR.nr.127/13 datë 13.03.2014,e ka anuluar aktgjykimin e Gjykatës së shkallës së parë dhe çështjen e ka kthyer në rigjykim.

Gjykata duke vepruar sipas kësaj akuze caktoi dhe mbajti shqyrtimet gjyqësore më datë 25.11.2015,24.12.2015,05.02.2106 dhe më datë 09.02.2016.

Prokurori i shtetit në Prokurorinë Themelore në Ferizaj-Departamenti për krime të Rënda, Florije Salihu Shamolli, ka mbetur në tërësi si pranë aktakuzës të paraqitur me shkrim dhe në fjalët përfundimtare të palëve ka deklaruar se në bazë të provave është vërtetuar që i akuzuari B.S. e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet, veprimi inkriminues i të akuzuarit është vërtetuar edhe nga dëshmitë e të dëmtuarave të dhëna në procedurë paraprake dhe në shqyrtimin gjyqësor dhe i ka propozuar Gjykatës që të akuzuarin ta shpallë fajtor dhe ta dënoj sipas ligjit.

Të dëmtuarat N.H. dhe L.P., kanë deklaruar në shqyrtimin gjyqësor se nuk i bashkëngjiten ndjekjes penale ndaj të akuzuarit dhe nuk kanë ndonjë kërkesë pasurore juridike.

Mbrojtësit e të akuzuarit, avokatët E.Sh. e B.S., në fjalët përfundimtare të palëve i kanë propozuar trupit gjykues që të akuzuarin ta liroj nga akuza në mungesë të provave, meqë me asnjë provë nuk është vërtetuar se i akuzuari ka kryer këtë veprë penale.

I akuzuari B.S. nuk e ka pranuar fajësinë për këtë veprë penale dhe në mbrojtjen e tij të dhënë në shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar se prej vitit 2001 e ka pas të regjistruar firmën private me emrin “”, e që është marr me punë ndërtimore siç janë

Në vitin 2009 është njoftuar me L.P. në një internet kafe në Ferizaj ku ajo punonte, aty ka shkuar së bashku me R.B.n, në ndërkohë është njoftuar edhe me N.H. që ishte shoqe e L.P., në fillim me N.H. ka dal vetëm për kafe në Ferizaj e pastaj edhe kanë pasur marrëdhënie intime disa herë, të njëjtës i ka dhënë disa herë shuma të parave prej 50 deri në 100 euro, me qëllim që t'i ndihmoj por njëherit ka deklaruar se edhe L.P.t i ka dhënë disa herë para kur ka pas nevojë. Në vitin 2011 i akuzuari bashkë me N.H. dhe L.P. kanë shkuar për pushime në qytetin e Sarandës në Shqipëri, kanë fjet në hotel në një dhomë të përbashkët e me tu kthyer për në Kosovë këto të dyja

janë ndalur në qytetin e Durrësit për të vazhduar pushimet ndërkaq i akuzuari është kthyer në Kosovë. Me tutje në mbrojtjen e tij ka deklaruar se me datë 27.11.2010 në 10 vjetorin e firmës së tij ka organizuar pritje të mysafirëve në motelin “” në Shtërpcë e në mesin e mysafirëve i ka ftuar edhe N.H. dhe L.P. të cilat kanë vallëzuar me ç’rast ua ka dhënë nga 50 euro secilës dhe me të përfunduar ahengu të njëjtat janë kthyer në shtëpitë e tyre. Gjatë ahengut të përcjellë me muzikë N.H. dhe L.P. kanë vallëzuar normalisht por nuk kanë pas veshje provokuese dhe nuk kanë qenë të ngacmuara nga mysafiret apo dikush tjetër.

Personin e quajtur R.B. e ka pas shok të shkollës dhe shoqërinë e kanë vazhduar edhe më tutje e që i njëjti është njoftuar me L.P. gjatë takimit që e kanë pas në internet kafen në Ferizaj, ky njoftim është bërë në mes tyre e jo me ndërmjetësimin e të akuzuarit, e që pastaj së bashku me R.B.in dhe L.P. e N.H. kanë dal shpesh për të pirë kafe, por që edhe kanë vazhduar në ndonjë restorant dhe atë i akuzuari me N.H. kurse dëshmitari R.B. me L.P.. Me tutje ka deklaruar se me R.B.n ka komunikuar edhe përmes bisedave telefonike meqë e ka pas shok por njëherit ka komunikuar edhe me persona të tjerë me të cilët ka pas bashkëpunim në çështjen e biznesit të firmës së tij, po ashtu në një aheng në vitin 2011 të organizuar nga një shok i kryetarit të Komunës së Shtërpcës ka marr pjesë bashkë me N.H. dhe L.P. të cilat i ka ftuar vet i akuzuari dhe aty kanë qenë në cilësi të mysafirëve.

Në fjalët përfundimtare të palëve ka propozuar që të lirohet nga akuza.

2. Provat e paraqitura në shqyrtimin gjyqësor

Gjykata në shqyrtimin gjyqësor ka paraqitur provat relevante për këtë çështje penale, të cilat i vlerësojnë një nga një dhe në ndërlidhje reciproke njëra me tjetrën siç parashihet në nenin 387 të KPPK-së, dhe në këtë mënyrë e vërtetoi gjendjen faktike të përshkruar si në dispozitiv të aktgjykimit.

Gjendjen faktike Gjykata e vërtetoi me këto prova:

- Nga mbrojtja e të akuzuarit B.S. e paraqitur në procedurë paraprake dhe në shqyrtimin gjyqësor,
- Deklaratat e dëshmitarëve N.H., L.P. e R.B. të dhëna në procedurë paraprake dhe në shqyrtimet gjyqësore,

Vlerësimi i provave të paraqitura në shqyrtimin gjyqësor, i dëshmimeve të dëshmitarëve dhe të gjeturat faktike të gjykatës

Trupi gjykues pasi vlerësoi të gjitha provat e paraqitura në shqyrtimin gjyqësor, i analizoi të gjitha një nga një dhe në ndërlidhje reciproke njëra me tjetrën për të konstatuar gjendjen faktike si në dispozitiv të aktgjykimit.

Trupi gjykues, vlerësoi dëshmitë e të dëmtuarave të dhëna në procedurë paraprake si dhe në shqyrtimin gjyqësor në cilësi të dëshmitareve dhe konstatoi se : i akuzuari B.S. ishte njoftuar fillimisht me dëshmitaren N.H. në vitin 2010 në një internet kafe në Ferizaj e pastaj bashkë me shoqen e saj L.P. dhe me të akuzuarin kanë dal nëpër restorante por kanë qenë edhe në pushime në qytetin e Sarandës në Shqipëri dhe me t’u kthyer për në Kosovë kjo me shoqen e saj L.P. janë ndalur në qytetin e Durrësit për të vazhduar pushimet.

Me të akuzuarin ka vazhduar shoqërinë dhe ka pas edhe marrëdhënie seksuale me dëshirën e saj por që i akuzuari disa herë i ka dhënë shuma të parave prej 50 apo 100 euro, kur dëshmitarja N.H. ka pas nevojë për para. Dëshmitarja bashkë me shoqen e saj L.P. kanë punuar pastaj si valltare në një restorant në qytetin Tetovë të R. Maqedonisë, ndërkaq i akuzuari B.S. e kishte organizuar në 10 vjetorin e firmës së tij një aheng dhe i ka ftuar N.H. dhe L.P. si mysafire me ç ‘rast në qytetin e Shtërpcës në një restorant të quajtur “” kanë shkuar atje kanë vallëzuar dhe i akuzuari ua ka dhënë secilës nga 50 euro.

Dëshmitarja ka deklaruar se shoqja e saj L.P. është njoftuar me personin R.B. dhe kanë pas raporte dashurie e që shpesh ka ndodh që të shkojnë së bashku pra i akuzuari B.S., dëshmitari

R.B. dhe dëshmitaret L.P. dhe N.H., në ndonjë hotel apo restorant ku edhe kanë qëndruar për një kohë të caktuar.

I akuzuari B.S., dëshmitares nuk i ka propozuar asnjëherë që të ketë marrëdhënie seksuale me ndonjë person tjetër me qëllim që të njëjtën ta punësoj apo t'i jep ndonjë beneficion tjetër, ka deklaruar dëshmitarja N.H..

Edhe dëshmitarja L.P. në shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar se deri sa ka punuar në një internet kafe në Ferizaj është njoftuar me të akuzuarin B.S. e që pastaj bashkë me të dhe me dëshmitaren N.H. janë shoqëruar dhe kanë dal neper restorante të ndryshme, njëherë kane shkuar për pushime në Shqipëri, ka deklaruar po ashtu se në ndërkohë është njoftuar edhe me personin R.B. me të cilin kanë dal dhe kanë pas po ashtu edhe marrëdhënie intime.

Dëshmitarja ka deklaruar se bashkë me N.H. kanë punuar në Tetovë të R. Maqedonisë dhe B.S. njëherë i ka ftuar në ahengun që e kishte organizuar për firmën e tij ku dëshmitarja bashkë me N.H. kanë vallëzuar aty e që i akuzuari për këtë i ka paguar nga 50 euro.

Dëshmitari R.B. ka deklaruar se prej vitit 2001 punon në komunën e Shtërpcës në Drejtorinë për Urbanizëm, të akuzuarin B.S. e ka pas shok të shkollës dhe e din që i njëjti e ka një firmë private. Me L.P. është njoftuar në një internet kafe në Ferizaj e pastaj kanë vazhduar shoqërinë dhe me të njëjtën kanë dal neper restorante meqë kanë qenë në lidhje dashurie, po ashtu disa herë kanë dal së bashku edhe me të akuzuarin B.S. dhe dëshmitaren N.H..

Nuk e ka mohuar faktin se me të akuzuarin B.S. përpos që ka pas shoqëri ka biseduar edhe përmes telefonit për çështje të ndryshme por asnjëherë në ndërlidhje me pozitën zyrtare të cilën e ka pas në komunën e Shtërpcës dhe të ndonjë përfitimi për të akuzuarin B.S..

Gjatë vlerësimit të këtyre dëshmimeve dhe krahasimit edhe me mbrojtjen e të akuzuarit, trupi gjykues konstatoi se dëshmitë dhe mbrojtja e tillë zbardhin gjendjen faktike, për më tepër veprimet e të akuzuarit në drejtim të veprës penale për të cilën akuzohet. Këto kur ndërlidhen

mes vete vërtetojnë vetëm faktet rreth kontaktit të të akuzuarit dhe njoftimit të tij me dëshmitaren N.H. dhe L.P., e që pastaj i akuzuari me dëshmitaren N.H. ka vazhduar edhe raportet intime siç ka vazhduar edhe dëshmitari R.B. me dëshmitaren L.P. pasi që është njoftuar me të njëjtën, se marrëdhëniet seksuale të të dëmtuarave me të akuzuarin B.S. dhe me dëshmitarin R.B., janë kryer me pëlqimin e të dëmtuarave dhe me dëshirën e tyre, siç është bërë edhe ndeja e tyre dhe vallëzimi ne ahengun e organizuar nga i akuzuari B.S..

Nga të gjitha provat e prezantuara edhe në procedurë paraprake edhe në shqyrtimin gjyqësor nuk është vërtetuar asnjë element i veprës penale trafikimi me njerëz nga neni 139 par. 1 i KPK-së, pra elementet kryesore të kësaj vepre rekrutimi, transportimi, strehimi dhe shfrytëzimi duke i detyruar që të kenë marrëdhënie seksuale të dëmtuarat me të akuzuarin apo me dikë tjetër, si elemente këto objektive të veprës penale si dhe nuk është provuar me asnjë provë se i akuzuari B.S., me këtë rast të ketë përfituar materialisht si element subjektiv i veprës penale, pra metodat e përdorura nga i akuzuari për realizimin e kësaj vepre penale po ashtu nuk janë vërtetuar me asnjë provë e që janë si para kushte që i paraprijnë qëllimit të përfitimit material.

Shkuarja e të dëmtuarave në motelin “” dhe vallëzimi i tyre me ç‘rast nga i akuzuari B.S. janë paguar për shumën prej nga 50 euro, shkuarja e të dëmtuarave bashkë me të akuzuarin në pushim në qytetin Sarandë të R.Shqipërisë, është vërtetuar se është bërë me dëshirën e të dëmtuarave, ndërkaq siç kanë deklaruar të dëmtuarat në deponimet e tyre, se i akuzuari të dëmtuarës N.H. i ka premtuar se do t’i ndihmoj në marrjen e lejes së vozitjes dhe edhe mundësinë rreth punësimit të saj, nuk nënkupton apriori dhe nuk paraqet fakte dhe rrethana konkrete që përbëjnë figurën e veprës penale trafikimi me njerëz nga neni 139 par. 1 i KPK-së.

Nga arsyet që u cekën, gjykata në mungesë të provave të akuzuarin e liroi nga akuza, nisur edhe nga fakti tjetër se mbi cilën palë bie barra e provës për fajësinë e të akuzuarit, ndërkaq çdo veprim tjetër i gjykatës do të konsiderohet si i kundërt dhe si lëvizje e barrës së provës nga organi i akuzës në të akuzuarin e që do të bije në kundërshtim esencial me parimet fundamentale të procedurës penale e paraparë kjo në nenin 7 të KPPK-së.

Andaj nisur nga këto që u cekën, Gjykata të akuzuarin e liroi nga akuza për veprën penale për të cilën akuzohet me akuzën e prokurorit të shtetit.

Vendimi për shpenzimet e procedurës penale është i bazuar në nenin 454 par. 1 të KPPK-së.

Nga të cekurat më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ
DEPARTAMENTI PER KRIME TE RENDA

PKR 73/14

Më datë 9 shkurt 2016

Sekretare juridike,
Qëndresa Bobi

Kryetari i trupit gjykues-gjyqtari,
Ibrahim Idrizi

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 15 dite, pas pranimit të kopjes së këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.

